

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Adresa: Pallati i Kongreseve Tel./Fax.: +355 (4) 23 53 63 Website: www<u>.cec.org.al</u> E-mail: infosec@cec.org.al

Deklarate e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve mbi administrimin e Zgjedhjeve Vendore 2003

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka reflektuar te gjithe pergjegjesine e vet institucionale ne pergatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve te Organeve te Qeverisjes Vendore te 12 Tetorit 2003. Rendesia e mbarevajtjes se ketij procesi zgjedhor ka kerkuar angazhimin e plote te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve dhe te strukturave te tij me qellim te siguroje zgjedhje te rregullta dhe te bazuara ne ligj. Ne te gjithe territorin zgjedhor, procedurat e votimit kane vijuar gjate gjithe dites se djeshme ne menyre te qete dhe normale.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e percakton si mjaft te rendesishem rolin dhe kontributin e rendesishem te te gjitha subjekteve zgjedhore ne pergatitjen e ketij procesi zgjedhor. Zbatimi i ligjit dhe akteve te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve nga ana e strukturave te Policise se Shtetit ka ndihmuar ne krijimin e nje klime te qete dhe te pershtatshme per zhvillimin e zgjedhjeve.

Pavaresisht nga pretendimet e disa subjekteve zgjedhore mbi listen e zgjedhesve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar ne fakte dhe prova te pamohueshme, garanton te gjithe subjektet se te gjitha procedurat e pergatitjes dhe prodhimit te kesaj liste jane konform vendimeve unanime te KQZ dhe kane gezuar konsensusin e plote te perfaqesuesve te partive te te gjithe spektrit politik shqiptar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i kerkon subjekteve zgjedhore qe te ndihmojne mbarevajtjen e procesit zgjedhor duke ndjekur procedurat e ankimimit te parashikuara ne dispozitat e Kodit Zgjedhor.

KQZ ka konstatuar raste problematike ne nje numer te qendrave te votimit lidhur me kapacitetin e kutive te votimit dhe ka perballuar me sukses kerkesat eventuale.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve falenderon Ministrine e Mbrojtjes, ate te Rendit, si edhe forcat e NATO-s ne Shqiperi per mbeshtetjen dhe gatishmerine qe treguan gjate dites se djeshme per te mundesuar transportimin ne nje kohe rekord te kutive shtese te votimit neper njesite vendore te territorit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlereson pranine e Misionit te Vezhgimit te Zgjedhjeve te OSBE/ ODIHR-it, si edhe ate te vezhguesve te tjere vendas dhe te huaj per garantimin e respektimit te procedurave ligjore gjate procesit te votimit.

#